

VENDIM
Nr. 536, datë 27.6.2013

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 934, DATË 26.12.2012 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË TË PËRKOHSHME, PËR
VITIN 2013, NË NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18 pika 2 të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 11 të ligjit nr. 119/2012, datë 17.12.2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 1 e vendimit nr. 934, datë 26.12.2012 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet si më poshtë vijon:

“1. Numri i punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2013, në njësitë e qeverisjes qendrore bëhet 993 veta. Shtesa prej 18 punonjësish është e detajuar sipas lidhjes nr. 6, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

2. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi përballohen nga shpenzimet korente të miratuara në buxhetin përkatës të institucionit për vitin 2013.

3. Ngarkohen ministritë dhe institucionet buxhetore sipas lidhjes nr. 6 të këtij vendimi, të depozitojnë pranë Ministrisë së Financave detajimin e numrit të punonjësve brenda kritereve të vendimit nr. 1703, datë 24.12.2008 “Për vendosjen e standardeve të shërbimeve dhe aktiviteteve sezonale/të përkohshme, për ministritë dhe institucionet buxhetore”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr. 6

Gr.	Emri i institucionit	Nr. i punonjësve	Emërtesa	Koha mesatare ditore	Periudhë kohore
16	Ministria e Brendshme	13			
	Qendra Shërbimit Administrimit Mjeteve Transportit	6	Teknik të mesëm	8 ore	3 muaj
	Qendrën Kombëtare Pritëse për Azilkërkuesit	1	Mjek	8 ore	6 muaj
	Qendrën Kombëtare Pritëse për Azilkërkuesit	1	Përkthyes	8 ore	6 muaj
	Qendrën Kombëtare Pritëse për Azilkërkuesit	1	Jurist	8 ore	6 muaj
	Qendrën Kombëtare Pritëse për Azilkërkuesit	2	Punonjës sociale	8 ore	6 muaj
	Qendrën Kombëtare Pritëse për Azilkërkuesit	1	Kuzhinier	8 ore	6 muaj
	Qendrën Kombëtare Pritëse për Azilkërkuesit	1	Sanitare	8 ore	6 muaj
25	Ministria e Punës Çështjeve Sociale, Shanseve të Barabarta	4			
	<i>Shtëpia e te moshuarve Tiranë</i>	2	Sanitare	6 ore	7 muaj
	<i>Shtëpia e te moshuarve Tiranë</i>	2	Kujdestar	6 ore	7 muaj
28	Zyra Administrimit Buxhetit Gjyqësor	1			
	<i>Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës</i>	1	Mirëmbajtës	8 ore	6 muaj
	Total	18			